



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 43 prot.

Kamëz, më 28.2025

V E N D I M  
Nr. 64. Datë 28.2025  
M B I

**“MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr. 60 Datë 25.08.2025 në mbështetje të nenit 2 pika 1, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, nenit 51 pika 4, nenit 54 shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, nenit 64 shkronja “h” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e kartës evropiane të autonomisë vendore”; Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar); dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim për marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatës jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe anëtarësimin e Bashkisë Kamëz në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë përfaqësimin e Bashkisë Kamëz në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur.
3. Të miratojë në parim efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Kamëz si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, në shumën e pëllogaritur sipas planit të financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe njësive të tjera anëtare të TALGA-s, si dhe sipas vendimit përkatës të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA-s.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Kamëz që të nënshkruajë marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025, dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, si dhe vendimeve të Asamblesë së TALGA-s.
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë që të përfaqësojë Bashkinë Kamëz në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organet e tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA-s, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Kamëz nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë së TALGA-s.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financave dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI  
HYSEN KOLDASHI**

